



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.9.2014, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për azilin në Republikën në Shqipërisë”.
3. Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.
4. Projektligji “Për të drejtën e informimit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Dashamir Peza, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Spartak Braho, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Ilirjan Mustafaraj – zëvendësministër i Punëve të Brendshme

Renata Palluçi – specialiste juridike në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Katrin Treska – drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Mirëmëngjesi!

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin nën për nën të projektligjit “Për azilin në Republikën në Shqipërisë”.

Nga Ministria e Brendshme kanë ardhur zoti zëvendësministër, Ilirjan Mustafaraj, si dhe zonja Renata Palluçi, specialiste juridike.

Neni 1. Ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Ulsi Manja – Zoti kryetar, unë propozoj që në pikën 2 të nenit 3 pas fjalëve “në çfarëdo mënyre” të shtohen fjalët “e në çfarëdo kohe”.

Për pikën 7 të këtij neni për termin “i mitur i pashoqëruar” ka pasur diskutime nëse do të përdorim fjalën “i mitur” apo “fëmijë”. Kushtetuta jonë dhe konventa përdorin termin “fëmijë”, ndërsa i gjithë korpusi tjetër ligjor, Kodi i Familjes, por edhe direktiva përdorin termin “i mitur”. Le ta vendosë komisioni se cilin term do të përdorim.

Fatmir Xhafaj – Termi “i mitur” është i përdorur në legjislacion dhe gjendet më lehtë.

Ulsi Manja – Edhe unë mendoj se duhet të përdoret termi “i mitur”, sepse i gjithë korpusi tjetër ligjor përdor këtë term. Gjithsesi, Kushtetuta dhe konventa kanë termin “fëmijë”.

Fatmir Xhafaj – Po direktiva?

Ulsi Manja – Në direktivë është përdorur termi “i mitur”.

Fatmir Xhafaj – Le të ecim me direktivën e BE-së.

Vasilika Hysi – Që të jetë më i përdorshëm si term është mirë që të vendosen sipas rendit alfabetik.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me sugjerimet? Dakord.

Miratohet neni 3, me sugjerimet përkatëse.

Neni 4. Ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. Ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. Ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7?

Ulsi Manja – Unë sugjeroj që neni 7 të kalojë si pikë 3 e nenit 6 me këtë përmbajtje:
“Për rastet përjashtimore azilkërkuesi mund të kthehet kur:

a- Ka arsye të bazuara dhe të arsyetuara në vendim për ta konsideruar si një rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

b- Është dënuar me vendim të formës së prerë për një krim që dënohet minimalisht me 7 vjet burg, i cili përbën një rrezik për rendin dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë”.

Arsyet janë të bazuara dhe të arsyetuara në vendim. Ky është një sugjerim për të cilin kemi rënë dakord edhe me përfaqësuesit e UNHCR-së.

Fatmir Xhafaj – Përfaqësuesit e ministrisë jeni dakord me këtë sugjerim? Në rregull.

Miratohet neni 7, me ndryshimin e propozuar.

Neni 8. Ka vërejte ose sugjerime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9.

Ulsi Manja – Për nenin 9 të projektligjit sugjerohet që të bëhet ky ndryshim: “I huaji që kërkon azil në Republikën e Shqipërisë duhet:

a- Të paraqesë kërkesën pranë autoriteteve kompetente policore”. Pra, të hiqet termi “...t’u drejtohet autoriteteve policore”.

b- “Të fillojë të plotësojë aplikimin për azil pranë autoritetit”.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Miratohet neni 9, me ndryshimet e propozuara nga relatori dhe ministria.

Neni 10.

Vasilika Hysi – Te paragrafi i parë i nenit 10 togfjalëshi “kanë krijuar bindjen” është evaziv, sepse në nenin 11 ju thoni se lista e vendeve të treta të sigurta është e miratuar, e ka BE-ja, dhe nuk mund t’i lihet një punonjësi të autoritetit policor që të vendosë nëse ekziston apo jo siguria. Pra, neni 10 me nenin 11 bien në kontradiktë.

Fatmir Xhafaj – Cili është propozimi juaj?

Vasilika Hysi – Nuk duhet të themi “kanë krijuar bindjen”, por “i përket një nga vendeve që gjenden në listën e vendeve të treta të sigurta”, që tashmë është i miratuar, apo jo?

Fatmir Xhafaj - Po, zonja Palluçi.

Renata Palluçi - Jemi dakord me propozimin.

Fatmir Xhafaj - Ka vërejtje të tjera? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. “Ndalimi i azilkërkuesve”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Te ky nen, te paragrafi i pestë flitet për vendosjen e të miturve. Të miturit nuk vendosen në asnjë rast në vendet e vuajtjes së dënimit. Këtu duhet të përcaktohet se ku vendoset një i mitur. Përveç rasteve ekstreme, është evazive...

Fatmir Xhafaj - Këtu është shprehur qartë: “Nuk mund të vendosen në institucionet...

Vasilika Hysi – Përveç rasteve ekstreme, pastaj vazhdon fjalia:”në çdo rast tjetër, ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët”, por nuk thuhet se ku vendosen. Duhet ta përcaktojë ligji se ku duhet të vendosen. Në ka gjë që nuk fal Këshilli i Europës është pikërisht kjo.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 13. Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 14.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam një vërejtje, përse duhet të jetë kaq detyruese kjo? Jam dakord që ministria përgjegjëse për çështjet e azilit, duhet të bashkëpunojë me zyrën e UNHCR-së, por të vihet në ligj që me kërkesën e UNHCR-së je i detyruar të japësh numrin e azilkërkuesve, zbatimin e konventës... Përse duhet ta vendosësh të shkruar në ligj?

Më duket pak denigruese për ministrin përgjegjës apo për atë që mbulon azilantin. Unë e di se çfarë është UNHCR-ja, por nuk mund të vihet në ligj që t’i ke detyrim 3, 4 , 5 gjëra. Në ligj mund të vihet që bashkëpunon me UNHCR-në dhe në kuadër të këtij bashkëpunimi mund të

bëhet një marrëveshje bashkëpunimi se çfarë kërkon UNHCR-ja në vazhdimësi me ministrinë e linjës. Pra, kjo gjë mund të vihet në atë marrëveshje, por nuk mund të vihet në ligj dhe ta detyrojmë me ligj. Me ligjin shqiptar detyrojmë ministrin shqiptar t'i thotë një zyre të huaj, që ti ministër shqiptar ke për detyrë të japësh 1, 2, 3, 4 dhe 5. Nuk më duket normale sesi është shkruar këtu. Jam dakord për bashkëpunimin e ministrisë me zyrën e UNHCR-së. Jam dakord në parim me frymën e nenit, por jo me mënyrën sesi është trajtuar pika 2 e këtij neni. Mbase duhet të riformulohet. Jam kundër.

Fatmir Xhafaj – Të dëgjojmë përfaqësuesin e ministrisë.

Ilir Mustafaraj - Për hir të së vërtetës, duhet të themi se kjo gjë ka qenë insistim i UNHCR-së. Në ligjin kroat është shkruar *mot a mot* siç e kemi shkruar edhe ne.

Unë e pranoj një lloj riformulimi, por është insistuar nga UNHCR-ja, që formulimi të jetë si në ligjin kroat, ku jemi mbështetur për të gjithë projektligjin.

Fatmir Xhafaj - Jeni dakord?

Bashkim Fino - Jam absolutisht kundër mendimit të përfaqësuesit të qeverisë, jo se jam më shqiptar unë sesa zëvendësministri i Brendshëm, por kur lexoj pikën 2 të këtij neni, acarohem me të vërtetë. Me kërkesë të UNHCR-së, pra kur të ketë mundësi ajo, kur të dojë ajo, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët duhet t'i dërgojë në mënyrë të rregullt informacion për numrin e azilkërkuesve në Republikën e Shqipërisë, për listën e anikimimeve, për zbatimin e konventës së Gjenevës, për legjislacionin brendshëm dhe të zbatueshëm. Çfarë bëni kështu? Ky është ligji ynë, që e bëjnë parlamentarët shqiptarë, është ligj për ministrinë tonë që mbulon një nga fushat e azilkërkuesve. Meqenëse është ligj i tillë, mua nuk më intereson se e ka Kroacia apo Anglia, por më intereson që si ligjvënës që jam, dua të ruaj autoritetin e qeverisë dhe të institucioneve të mia. Jam pro bashkëpunimit me zyrën e UNHCR-së.

Neni 14 mund të vihet vetëm me një paragraf ku të thuhet se ministria përgjegjëse për çështjet e azilit dhe të refugjatëve duhet të bashkëpunojë patjetër ngushtë me zyrën e UNHCR-së dhe të ketë një marrëveshje bashkëpunimi. Kaq dhe mbyllet këtu.

Zoti kryetar, në marrëveshjen e bashkëpunimit që mund të ketë ministri përgjegjës me zyrën e UNHCR-së, mund të vihen pika të caktuara, për shembull t'i lihet detyrë që kur ka ndryshime të legjislacionit, t'i vihet në dispozicion UNHCR-së, kur kjo e fundit kërkon ndonjë informacion, duhet t'ia japësh, por jo t'ia vëmë në ligj, ta detyrojmë me ligj, sepse nesër ngrihet zyra e UNHCR-së dhe thotë: hajde këtu ti ministër, e ke me ligj, të më sjellësh deri në orën

12:00 këto të dhëna. Unë e bëj ligjin për ministrin tim, për qeverinë time dhe për shtetin tim, nuk e bëj për një zyrë të huaj. Jam kundër mënyrës sesi është trajtuar pika 2 e nenit 14. Jam për bashkëpunimin, por jo kështu siç është bërë. Mos harroni një gjë, këtë e kam edhe për shkak të eksperiencës, sepse kam drejtuar dhe kam bashkëpunuar me UNHCR-në, unë dhe zoti Klosi, i cili mund të flasë. Absolutisht, pa ndihmën e shtetit shqiptar, të qeverisë, si edhe të ministrisë së linjës nuk ka se çfarë bën UNHCR-ja.

Ne e detyrojmë me ligj, që t'i japim pesë të dhëna. Jo! Të dhënat t'ia japim në formë bashkëpunimi, por jo të shkruar në ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Këtu ka procedura. Kur të vijë radha.

Zoti Mustafaraj, cili është komenti juaj?

Ilir Mustafaraj – E pranojmë vërejtjen. Jemi dakord të riformulohet.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Meqenëse edhe qeveria e pranon vërejtjen të riformulohet, t'i kalojë komisionit përgjegjës për ta riformuluar.

Vetëm duhet të mbani parasysh që janë konventa dhe nga konventat nuk lëvizet. Kur një shtet anëtar nënshkruan konventën, duhet të respektojë detyrimet deri në një. Kjo është shumë e rëndësishme. Në qoftë se është në konvent, nuk mund të ketë përjashtim nga konventa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju e dhatë komentin tuaj, unë timin.

Ata e kanë sjellë, nuk e kam sjellë unë projektin.

Bashkim Fino – Nuk kam asgjë personale me ty dhe ti nuk ke asgjë personale me mua. Në qoftë se duhet ta rishikojmë këtë nen, atëherë ta rishikojmë. Por pasi e ke hedhur në votim, pasi ke thënë “jam dakord”, të thuash “e ka konventa”, mua nuk më duket normale.

Fatmir Xhafaj – Nuk thashë absolutisht fare ashtu dhe ju mos e deformoni fjalën time.

Thashë saktësisht: “Shikoni konventën. Respektoni konventën dhe komisioni përgjegjës ta shikojë”.

Neni 15. Dakord. Ne e miratuam me vërejtje, me sugjerim. Komisioni përgjegjës është komision përgjegjës. Ky është rregulli.

Neni 16. Dakord.

Neni 17.

Ulsi Manja – Në nenin 17, zoti kryetar, sugjerohet që pika 2 të riformulohet si vijon:
“Aplikimi për azil i një të mituri të pashoqëruar duhet të trajtohet menjëherë”.

Fatmir Xhafaj –Ka vërjeje? Dakord, me sugjerimin e relatorit.

Neni 18. Dakord.

Neni 19. Dakord.

Neni 20. Dakord.

Neni 21. Dakord.

Neni 22. Dakord.

Neni 23. Dakord.

Neni 24. Dakord.

Neni 25. Dakord.

Neni 26.

Ulsi Manja – Në nenin 26, shkronja “a” e pikës 2, sugjerojmë të formulohet si vijon:
“Deri në revokimin e statusit të refugjatit”.

Fatmir Xhafaj – Dakord? Edhe ministria është dakord me këtë ndryshim.

Miratohet me këtë ndryshim.

Neni 27. Jeni dakord?

Dakord.

Neni 28. Dakord?

Dakord.

Neni 29. Dakord.

Neni 30. Dakord.

Neni 31. Dakord.

Neni 32. Dakord.

Neni 33. Dakord.

Neni 34. Dakord.

Neni 35. Dakord.

Neni 36. Dakord.

Neni 37. Dakord.

Neni 38. Dakord.

Neni 39. Dakord.

Neni 40. Dakord. “Pranimi i aplikimit për azil”

Neni 41. Dakord.

Neni 42. Dakord.

Neni 43. Dakord.

Neni 44. Dakord.

Neni 45. Dakord.

Neni 46.

Ulsi Manja – Për nenin 46 nuk kemi gjetur konsensus me UNCHR-në. Ata propozojnë që në pikën “a” të thuhet: “Refugjati pohon vullnetarisht me shkrim dhe në një gjuhë që ai kupton, se gëzon mbrojtjen e vendit të origjinës ose të ndonjë vendi tjetër të vendqëndrimit të tij të mëparshëm.” dhe sugjeron që shkronjat “dh” dhe “e” të hiqen.

Mendimi im si relator është që shkronja “a” duhet të qëndrojë kështu siç është, sepse shtrohet problemi që shumë nga azilkërkuesit mund të mos dinë shkrim dhe pavarësisht se intervista mund të merret në gjuhën që ai kupton dhe mund të fiksohet edhe nga autoritetet përgjegjëse që i presin në pikat e kalimit, por të vendoset si detyrim nënshkrimi kur azilkërkuesi mund të mos dijë shkrim, kjo besoj se është shumë detyruese për organet kompetente.

Ndërsa për shkronjat “dhe” dhe “e” ne nuk jemi dakord të hiqen. Sugjerojmë të qëndrojnë kështu si janë.

Fatmir Xhafaj – Është dakord ministria me relatorin?

Renata Palluçi – Jemi dakord me relatorin.

Vasilika Hysi - Në fakt, vendimi për këtë duhet bërë me shkrim, sepse mund të ketë abuzime dhe të thotë që e ka pohuar me gojë dhe nuk e vërteton dot gjatë procesit të ankimimit, por duhet shtuar një paragraf: në rast se azilanti ose refugjati nuk di shkrim e këndim, deklarata bëhet në prani të avokatit dhe në qoftë se keni mundësi, nuk e di si i keni kushtet, sot Këshilli i Europës kërkon regjistrimin audio-video. Ndryshe mund të deportohen të gjithë njerëzit e të thuhet: “Thanë me gojë që duan të ikin”.

Ilirian Mustafaraj – Mënyra e procedimit, në fakt, i përket procedurave dhe standardeve profesionale që zbatohen në intervistën që bëhet në pikat e kontroll-kalimit dhe gjykoj se ta ngarkosh ligjin edhe me këto procedura, do të dalë pak si e tepërt. Këto përcaktohen edhe në aktet e tjera nënligjore, siç është ajo që thotë deputetja e nderuar për regjistrimin audio-video.

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se ne e vendosim aty kur është e mundur...

Ilirian Mustafaraj – Kur është e mundur, do të thosha unë, që ta zgjidhim me shkrim, që ta përmbledhim, për arsye se vërtet ka raste që ata nuk dinë as shkrim, as këndim. Atëherë ndoshta duhet shkruar plotësimi “që kur është e mundur të merret me shkrim”. Sepse nuk kemi se çfarë i bëjmë kur ai nuk di shkrim e këndim.

Vasilika Hysi – Si rregull merret me shkrim.

Fatmir Xhafaj – Ne mund të vendosim edhe këtë, mundësinë e marrjes audio-video. Le të jetë në ligj

Dakord?

Ilirian Mustafaraj – Kjo nuk është thënë as në direktiva, për hir të së vërtetës.

Merret vesh sepse ai flet në një lloj gjuhe, me gisht.

Vasilika Hysi – Po si e lexon atë që është shkruar.

Ilirian Mustafaraj – Ia thotë ai që e shkruan, sepse bëhet në prezencë ose të përkthyesit, ose...

Fatmir Xhafaj – Dakord, ta lëmë alternative edhe mundësinë e zonjës Hysi dhe ta riformulojë relatori me sugjerimin që është bërë për t’ia kaluar komisionit përgjegjës.

Jeni dakord? Dakord.

Miratohet neni 46 me sugjerimet e bëra nga zonja Hysi dhe nga relatori, duke e riformuluar vërejtjen e bërë.

Neni 47. Jeni dakord?

Dakord.

Neni 48. Dakord.

Neni 49. Dakord.

Neni 50. Dakord.

Neni 51. Dakord.

Neni 52. Dakord.

Neni 53. Dakord.

Neni 54. Dakord.

Neni 55. Dakord.

Neni 56. Dakord.

Neni 57. Dakord

Neni 58. Dakord.

Neni 59. Dakord.

Neni 60. Dakord.

Neni 61. Dakord.

Neni 62. Dakord.

Neni 63. Dakord.

Neni 64. Dakord.

Neni 65. Dakord.

Neni 66. Dakord.

Neni 67.

Ilirian Mustafaraj – Propozoj që në nenin 67 të hiqet nga pika 2 lidhëza “edhe”, dhe në po këtë nen, në pikën 2, shkronja “b” fjalët “marrëdhëniet e plota martesore”, të zëvendësohen me “marrëdhënie martesore”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me sugjerimet e relatorit? Ministria, dakord? Dakord dhe ministria.

Faleminderit!

Neni 68? Dakord!

Neni 69? Dakord!

Neni 70? Dakord!

Neni 71? Dakord!

Neni 72?

Ulsi Manja – Për nenin 72 ka një sugjerim, të shtohet fjala “përfundimi i lejes së përkohshme”. UNCHR-ja sugjeron që kjo leje të përfundojë: c- Kur i huaji largohet nga Republika e Shqipërisë në mënyrë të përhershme. Edhe për këtë pikë nuk kemi pasur konsens me përfaqësuesit e UNCHR-së dhe në cilësinë e relatorit sugjeroj që neni 72 të ngelet kështu siç është formuluar.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Dakord me relatorin.

Neni 73? Dakord!

Neni 74? Dakord!

Neni 75? Dakord!

Neni 76? Dakord!

Neni 77?

Ulsi Manja – Në nenin 77 sugjeroj që fjalët “përshtaten ndaj të huajve” të bëhen “përshtaten edhe ndaj të huajve”.

Fatmir Xhafaj – Dakord ministria?

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 78? Dakord!

Neni 79? Dakord!

Neni 80? Dakord!

Neni 81? Dakord!

Neni 82? Dakord!

Neni 83? Dakord!

Neni 84? Dakord!

Neni 85? Dakord!

Neni 86? Dakord!

Neni 87?

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Zoti Fino, ju lutem me mikrofon, se po regjistrohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Një minutë, se do të regjistrohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Fino, të lutem, nuk mund të bësh rregulla të reja. Do të regjistrohet, sepse është për efekt procesverballi. Si do ta kaloj vërejtjen tuaj unë, në qoftë se...

(Diskutime pa mikrofon)

Po mos fol, atëherë, në qoftë se...

Bashkim Fino – Do të flas, do të flas.

Fatmir Xhafaj – Po me mikrofon, jo si do ti.

Bashkim Fino – Ti më dhe leje.

Fatmir Xhafaj – Po fol me mikrofon, që të regjistrohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Dakord, neni 87.

Bashkim Fino – Po pra! Çfarë ke që je nervoz? Mos ji nervoz! Çfarë ke? Është ligj shumë i mirë ky. Kaloi.

Fatmir Xhafaj – Zbato rregullin.

Bashkim Fino – Rregullin e zbatoj unë. Kam vërejtje për nene të caktuara e ti i kalon me shpejtësi.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Bashkim Fino – Jo, thuaj më fal, mos thuaj dakord!

Fatmir Xhafaj – Neni 87. Kam vërejtje për “gjashtë muaj”, duhet të jetë më pak, sepse, siç na tha edhe ministri këtu, kur bëri prezantimin, janë të gatshëm që aktet ligjore të dalin më pak, më pak se gjashtë muaj. Do të ishte mirë vërtet që aktet ligjore të dalin në më shumë kohë se brenda tre muajve. Dhe te pika 2, kryetar, kam një sugjerim. Këtu ngarkohen ministrinë përgjegjëse të linjave të tjera për të nxjerrë aktet nënligjore. Mos duhet që te kjo pika 2 ta lëmë, si të thuash, drejtuese ministrinë e linjës, që të interesohet me ministrinë e tjera që, që janë të interesuara për këto pika për të nxjerrë aktet nënligjore. Se po nuk që ministria e linjës e interesuar për të nxjerrë aktet nënligjore, po themi me Ministrinë e Punës, me Ministrinë e Arsimit, jam shumë i bindur se këto ministrinë e tjera, po s’ua kujtoi dikush, nuk mund të jenë të gatshme.

Mbase do të ishte mirë që ministria e linjës, së bashku me ministrinë e tjera, ministria përgjegjëse për këtë çështje, së bashku me ministrinë e tjera të linjës, brenda tre muajve do të dilnin aktet nënligjore për këto pika që janë këtu: 9, 2, 3, 21 e kështu me radhë.

E kam më tepër në sensin që, kur ministria përgjegjëse shkon te ministria tjetër, e vë përpara një përgjegjësie duke ia kujtuar se do të bëjmë këto akte nënligjore së bashku. Ministria e Brendshme me Ministrinë e Arsimit, Ministria e Brendshme me Ministrinë e Çështjeve sociale. Mbase do të ishte më mirë po ta korrigjonim kështu, them unë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mustafaraj?

Ilirjan Mustafaraj – Po flas për pjesën e dytë, më duket teknikë legislative, që është shkruar në këtë mënyrë. Sa i përket afatit, është një proces jashtëzakonisht i ngarkuar me të gjitha aktet nënligjore jo vetëm për këtë ligj, por edhe për një paketë të tërë ligjore siç ishte paketa e sigurisë, që ka kaluar edhe këtu në komision. Është gati-gati në limite të pamundura periudha tremujore. Prandaj e kemi vënë gjashtë muaj, sepse kemi shumë, vërtetë shumë akte të tjera nënligjore për të paraqitur.

Fatmir Xhafaj – Dakord! Pra, s’jeni dakord? Doni gjashtë muaj? Te pika 2, keni gjë për të thënë në lidhje me vërejtjen që u bë? Pra, që t’i lihet ministrisë përgjegjëse?

Ilirjan Mustaraj – Përgjegjëse për pjesën tonë, po për pjesën tjetër...

Fatmir Xhafaj – Unë s’jam dakord me të dyja këto. Jam dakord që ky nen të rishikohet dhe propozoj të përcaktohen se cilët janë ministrat. Do ta kenë në ligj, detyrim. Nuk është çështja t’i kalojnë ministrit përgjegjës. Ministri përgjegjës nuk e detyron dot ministrin tjetër. Prandaj të rishikohet e të përcaktohet ekzaktësisht. Kur t’ia çojnë propozimin Komisionit të Sigurisë, këshilltarët t’ua çojnë me ministria filan, ministri përgjegjës për këtë, ministri përgjegjës për atë, në bazë të zbatimit të saj. Ku janë të përbashkëta, do t’i vënë të përbashkët. Biem dakord?

Ilirjan Mustaraj – Dakord jam në parim, po këta juristët më thonë se është teknikë legjislative e shkruar...

Fatmir Xhafaj – Përkundrazi, është detyrim i Kushtetutës.

Neni 87? Dakord me sugjerimin?

Neni 88? Dakord!

Neni 89: “Hyrja në fuqi”. Dakord?

Para votimit në tërësi, ka gjë për të thënë ndonjë nga kolegët?

Të lutem, zoti Frroku! Keni ndonjë gjë juve, ju lutem?

(Diskutime pa mikrofon)

Nenin 14. Dakord!

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 14 është votuar, miku im!

Në tërësi, kush është dakord?

Armando Subashi – Kam diçka unë. A mund ta them? Te neni 84...

Fatmir Xhafaj – Në tërësi u votua dakord! E lëmë tani. Më vjen keq. Kalojeni te Komisioni i Sigurisë!

Miratohet në tërësi, me vërejtjet e sugjerimet përkatëse.

(Diskutime pa mikrofon)

Në Ministrinë e Brendshme.

Armando Subashi – Ka të drejtën t’i garantojë kushtet themelore të jetesës dhe strehimit. Kaq.

(Diskutime pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.09.2014, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Dashamir Peza, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Spartak Braho, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Katrin Treska – drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, vetëm për votimin në parim, ju është shpërndarë me vërejtje e sugjerimet që keni mbi tavolinë.

Kush është dakord?

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, ju lutem! Kush është dakord? Në rregull. Kundër? Abstenime? Vetëm një kundër: zoti Ndoka.

Miratohet me vërejtjet dhe sugjerimet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 16.09.2014, 9.00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “ Për të drejtën e informimit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Tahir Muhedini, Piro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Silva Caka, Mark Frroku dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Dashamir Peza, Kastriot Islami, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Spartak Braho, Eduard Halimi dhe Gent Strazimiri.

Të ftuar:

Katrin Treska – drejtore e Drejtorisë së Hartimit dhe Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Kalojmë te projektligji “Për të drejtën e informimit”. Është riparë, siç u la këtu, neni 18, riformulimi. Dakord me nenin 18?

Me nenin 19, i riformuluar?

Me nenin 20, dakord?

Paragrafin e fundit: “Avokati i Popullit dhe Komisionari” po e heqim prej këtu, për ta vendosur te “Ligji për Avokatin e Popullit”. Dakord me këto ndryshime që janë bërë në këto nene, siç u ra dakord dje?

Kush është dakord në tërësi?

Faleminderit!

Miratohet edhe ligji “Për të drejtën e informimit”.

E mbylлим për sot me të tre ligjet e miratuara. Faleminderit!

Ditë të mbarë!

